



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2648/2 prot.,

Datë 31.10.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT TË
OPERATORIT EKONOMIK ANKIMUES DHE PRETENDIMET MBI SKUALIFIKIMIN
E OFERTUESVE TË TJERË**

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “REJ” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedure e hapur-Pune-Elektronike*”, me Nr. REF-78330-08-25-2023, me objekt: “*Sistemim i Lumit të Buçimasit dhe Rehabilitimi i Infrastrukturës Rrugore*”, me fond limit 79.282.029 (Shtatëdhjetë e nëntë milion e dyqind e tetëdhjetë e dy mijë e njëzet e nëntë) lekë pa-TVSH, zhvilluar më datë 19.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec.

Mbetjen të skualifikuar të operatorit ekonomik “*L.T.E CONSTRUCTION*” SHPK, pasi nuk ka plotësuar kriteret e veçanta të kualifikimit, konkretisht: pikën 2.3.3; 2.3.6; 2.3.8; 2.3.9; 2.3.10 dhe 2.4.2 “*KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT*” të Shtojcës 7 të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimimi.

Mbetjen të skualifikuar të operatorit ekonomik “*SHENDELLP*” SHPK, pasi nuk ka plotësuar kriterin e veçantë të kualifikimit, konkretisht: pikën 2.3.3 “*KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT*” të Shtojcës 7 të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimimi.

Mbetjen të skualifikuar të operatorit ekonomik “*BE-IS*” SHPK, pasi nuk ka plotësuar kriterin e veçantë të kualifikimit, konkretisht: pikën 2.3.3 “*KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT*” të Shtojcës 7 të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimimi.

Mbetjen të skualifikuar të operatorit ekonomik “*DESARET COMPANY*” SHPK, pasi nuk ka plotësuar kriterin e veçantë të kualifikimit, konkretisht: pikën 2.3.3 “*KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT*” të Shtojcës 7 të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimimi.

Mbetjen të skualifikuar të operatorit ekonomik “*RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN*” SHA, pasi nuk ka plotësuar kriterin e veçantë të kualifikimit, konkretisht: pikën 2.3.3 “*KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT*” të Shtojcës 7 të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimimi.

Mbetjen të skualifikuar të operatorit ekonomik “*VARAKU-E*” SHPK, pasi nuk ka plotësuar kriteret e veçanta të kualifikimit, konkretisht: pikën 2.3.1 dhe 2.3.3; “*KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT*” të Shtojcës 7 të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimimi.

Ankimues:

Operatori ekonomik “*REJ*” SHPK me NIPT: J93711608Q dhe me adresë: *Zogu i Zi, Qatar Center, kati 2, Tiranë.*

Subjekte të Interesuara:

Operatori ekonomik “*L.T.E CONSTRUCTION*” SHPK me NIPT: L78006801F dhe me adresë: *Rruga “3 Dëshmorët” Godinë banimi dhe shërbimi 1,2,5,8 dhe 11 kate me 2 kat parkim nëntoke në pronë të shoqërisë “Lloxhall”, Kashar Tiranë.*

Operatori ekonomik “*SHENDELLI*” SHPK me NIPT: K07924803N dhe me adresë: *Lagjja “Kastrioti”, Rruga “Andon Profka”, 2 kullat, Fier.*

Operatori ekonomik “*BE-IS*” SHPK me NIPT: K71412003A dhe me adresë: *Lagjja nr 1, Pallati “Metalurgu”, Hyrja nr.1, Kukës.*

Operatori ekonomik “*DESARET COMPANY*” SHPK me NIPT: K01816001J dhe me adresë: *Njësia Bashkiake nr 11, Rruga “Hysni Gerbolli”, Pallati “Desaret”, Pranë Kryqit të Kuq, Kati përdhe, Tiranë.*

Operatori ekonomik “RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN” SHA me NIPT: J62904264O dhe me adresë: *Fshati Balëz Poshtë, Zona kadastrale nr.1079, Nr. pasurisë 322/11, 1 km nga kryqëzimi i fshatit Kusarth (në kryqëzimin e rrugës së fabrikës së çimentos rrugën e fshatit Balëz Sipër), Bradashesh, Elbasan.*

Operatori ekonomik “VARAKU-E” SHPK me NIPT: J61902509S dhe me adresë: *Godinë private, Zona Kadastrale 3852, Nr.Pasurie 19/30, Xhafzotaj, Durrës.*

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Pogradec

Adresa: Lagja nr 2, Bulevardi "Reshit Çollaku", Pogradec.

Në datën 30.10.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2648/2023 protokoll dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3547 e operatorit ekonomik “REJ” SHPK për procedurën e prokurimit *Procedure e hapur-Pune-Elektronike*, me Nr. REF-78330-08-25-2023, me objekt: *“Sistemim i Lumit të Buçimasit dhe Rehabilitimi i Infrastrukturës Rrugore”*, me fond limit 79.282.029 (*Shtatëdhjetë e nëntë milion e dyqind e tetëdhjetë e dy mijë e njëzet e nëntë*) lekë pa-TVSH, zhvilluar më datë 19.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, konstatohet se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “REJ” SHPK, si dhe kërkon mbetjen të skualifikuar për ofertat e paraqitura e nga operatorët ekonomikë “L.T.E CONSTRUCTION” SHPK, “SHENDELLI” SHPK, “BE-IS” SHPK, “DESARET COMPANY” SHPK, “RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN” SHA dhe “VARAKU-E” SHPK, pasi nuk ka plotësuar kriteret e veçantë të kualifikimit, të Shtojcës 7 të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “b” dhe “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”*

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “REJ” SHPK, e cila kundërshtohet në ankesën me nr. 2648/2023 protokoll, datë 30.10.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

“Nga Operatori Ekonomik “REJ” shpk me NIPT J93711608Q, është paraqitur oferta ekonomike me vlerë: 70,743,198 (shtatedhjetë million e shtateqind e dyzet e tre mijë e njeqind e nentedhjetë e tete) leke pa TVSH, nuk ka arritur te paraqitet i gjithe dokumentacioni i plotë dhe i saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim siç kërkohen në DT, konkretisht: - Nuk ploteson pikën 2.4.2 te DST, lidhur me autorizimin nga Prodhuesi / Distributori i autorizuar, per elementin Materiale Elektrike, pasi nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur ne SPE, rezulton se OE ofertues ka paraqitur autorizim distributori nga “Elal COM”, i cili eshte distributori i prodhuesit “Tubifor SRL” per furnizimin me materiale elektrike, por nuk ka paraqitur dokumentacion (kontrate/autorizim) qe verteton lidhjet e firmes prodhuese me distributorin, ashtu sic kerkohet ne DT.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me Ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe Dokumentave Standarde të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e “REJ” shpk me NIPT J93711608Q, nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar si ofertë të pavlefshme.”.

Gjithashtu Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret të cilat operatori ekonomik ankimues “REJ” SHPK, pretendon se nuk përmbushen nga operatorët ekonomikë “L.T.E CONSTRUCTION” SHPK, “SHENDELLI” SHPK, “BE-IS” SHPK, “DESARET COMPANY” SHPK, “RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN” SHA dhe “VARAKU-E” SHPK pjesmarrës në procedurë.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje nga ana e operatorëve ekonomikë “L.T.E CONSTRUCTION” SHPK, “SHENDELLI” SHPK, “BE-IS” SHPK, “DESARET COMPANY” SHPK, “RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN” SHA dhe “VARAKU-E” SHPK, pjesmarrës në procedurë të kriterëve kualifikues, përkatësisht si më poshtë vijon:

Operatori ekonomik “L.T.E CONSTRUCTION” SHPK nuk plotëson kriteret kualifikuese si më poshtë:

“2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.3 Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Leje Mjedisi tipi III.1.B “Menaxhim i Mbetjeve” për aktivitetin ID 5.6 pika b) Magazinim i mbetjeve në lidhje me zbatimin e veprimtarive të pikës 5.6 a ku të jenë të përfshirë kodet 20 02 02 (Dhera dhe Gurë); 20 03 07 (Mbetje të vëllimshme); 20 03 99 (Mbetje urbane të paspecifikuara).

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërisë i cili të ketë kontratë pune, diplomë, licensë Urdhër Mjeku dhe të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues për periudhën Maj - Korrik 2023 dhe në vazhdim, ose duhet të paraqitet një

kontratë e vlefshme për ofrimin e këtij shërbimi me një subjekt të liçensuar sipas ligjit. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, secili nga operatorët ekonomikë duhet ta plotësojë këtë kusht në përputhje me numrin respektiv të punonjësve sipas kërkesave ligjore.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

2.3.8. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 65 (gjashtedhete e pese) persona për periudhën Maj – Korrik 2023, e vertetuar kjo me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën Maj - Korrik 2023.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Maj - Korrik 2023.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjës minimumi:

Specialiste:

Elektricieste	2
Hidraaulike	2
Karpentier	3
Pllakashtrues	3
Hekurkthyes	3

të vertetuar me diploma/certifikata të arsimit profesional të lëshuara nga institucionet të akredituara/ liçensuara sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” ose ekuivalente, kontratë pune të vlefshme, si dhe të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë të pakten për periudhën Maj- Korrik 2023 dhe në vazhdim.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

2.3.10 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 6 (gjashte) manovratore si dhe 14 (katërmbledhete) shofere.

Per manovratorët deshmite e aftësi profesionale nga DPSHTRR, të cilat duhet të jenë të vlefshme, dhe të figurojnë në listëpagesa të pakten për periudhën Maj - Korrik 2023 dhe në vazhdim ose kur mjetet disponohen me qera drejtuesit e mjeteve mund të disponohen sëbashku me mjetet e mara me qera, pa pasur nevojë të jenë të përfshirë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues.

Per shoferët leje drejtimi e vlefshme dhe të figurojnë në listëpagesa të pakten për periudhën Maj - Korrik 2023 dhe në vazhdim ose kur mjetet disponohen me qera drejtuesit e mjeteve mund të disponohen sëbashku me mjetet e mara me qera, pa pasur nevojë të jenë të përfshirë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, ose nëse do të jetë nevojë për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.2 *Ne përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit perkates, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/kontrate bashkepunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/mallra në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë:*

- *Materialet hidraulike (Tub PVC etj)*
- *Pllaka/Bordura betoni*
- *Materiale elektrike*

Për rastin kur autorizimi do të jetë lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin (kontratë/autorizim) që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

SHËNIM: *Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (të ndryshuar), ku konkretisht në pikën 6 të nenit 26 parashikohet:.....Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.....*

Përsa më sipër, ofertuesi i kualifikuar, i pari, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin, e parashikuar në pikën 6 të nenit 26, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (të ndryshuar), brenda afatit 5 (pesë) ditor që ka në dispozicion autoriteti kontraktor, për publikimin e njoftimit të fituesit, sipas nenit 97/1, të LPP-së."

Operatori ekonomik "SHENDELLI" SHPK nuk plotëson kriterin kualifikues si më poshtë:

"2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.3 Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Leje Mjedisi tipi III.1.B “Menaxhim i Mbetjeve” për aktivitetin ID 5.6 pika b) Magazinim i mbetjeve në lidhje me zbatimin e veprimtarive të pikës 5.6 a ku të jenë të përfshirë kodet 20 02 02 (Dhera dhe Gurë); 20 03 07 (Mbetje të vëllimshme); 20 03 99 (Mbetje urbane të paspecifikuara).”.

Operatori ekonomik “BE-IS” SHPK nuk plotëson kriterin kualifikuese si më poshtë:

“2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.3 Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Leje Mjedisi tipi III.1.B “Menaxhim i Mbetjeve” për aktivitetin ID 5.6 pika b) Magazinim i mbetjeve në lidhje me zbatimin e veprimtarive të pikës 5.6 a ku të jenë të përfshirë kodet 20 02 02 (Dhera dhe Gurë); 20 03 07 (Mbetje të vëllimshme); 20 03 99 (Mbetje urbane të paspecifikuara).”.

Operatori ekonomik “DESARET COMPANY” SHPK nuk plotëson kriterin kualifikuese si më poshtë:

“2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.3 Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Leje Mjedisi tipi III.1.B “Menaxhim i Mbetjeve” për aktivitetin ID 5.6 pika b) Magazinim i mbetjeve në lidhje me zbatimin e veprimtarive të pikës 5.6 a ku të jenë të përfshirë kodet 20 02 02 (Dhera dhe Gurë); 20 03 07 (Mbetje të vëllimshme); 20 03 99 (Mbetje urbane të paspecifikuara).”.

Operatori ekonomik “RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN” SHA nuk plotëson kriterin kualifikuese si më poshtë:

“2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.3 Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Leje Mjedisi tipi III.1.B “Menaxhim i Mbetjeve” për aktivitetin ID 5.6 pika b) Magazinim i mbetjeve në lidhje me zbatimin e veprimtarive të pikës 5.6 a ku të jenë të përfshirë kodet 20 02 02 (Dhera dhe Gurë); 20 03 07 (Mbetje të vëllimshme); 20 03 99 (Mbetje urbane të paspecifikuara).”.

Operatori ekonomik “VARAKU-E” SHPK nuk plotëson kriteret kualifikuese si më poshtë:

“2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë **jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;**

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është **jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet;**

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten :

1. Formularin e vleresimit sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me;
2. Kontratë
3. Situacionin përfundimtar;
4. Aktin e kolaudimit;

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten

1. Kontrate;
2. Situacionin përfundimtar;
3. Akt kolaudimi;
4. Fatura tatimore

2.3.3 Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Leje Mjedisi tipi III.1.B “Menaxhim i Mbetjeve” për aktivitetin ID 5.6 pika b) Magazinim i mbetjeve në lidhje me zbatimin e veprimtarive të pikës 5.6 a ku të jenë të përfshirë kodet 20 02 02 (Dhera dhe Gurë); 20 03 07 (Mbetje të vëllimshme); 20 03 99 (Mbetje urbane të paspecifikuara).”.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 31.10.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Nënkryetar
Fiorent Zguro**

**Anëtar
Kreshnik Ternova**

**Anëtar
Anila Malaj**

**Kryetar
Jonaid Myzyri**